**Varianti 2:** Nga pakujdesia e një bujku i cili në fushë ishte duke djegur hamullishte, në zonën Zhegër-Nasalë, zjarri ka dalë nga kontrolli dhe nën ndikimin erës ka filluar të përhapet në drejtim të fshatit Lladovë dhe Partesh. Për shkak të temperaturave të larta, zjarri i shkaktuar në orët e vona të pasdites me shpejtësi depërton deri afër shtëpive të fshatit Partesh ku ndizen dy mullar me kashtë, një objekt përcjellës dhe një stallë. Në përpjekje për të shpëtuar bagëtinë dy persona alivanosen nga ekspozimi i dyoksidit të karbonit të cilët kërkojnë ndihmën mjekësore dhe transport deri në qendrën medicinale më të afërt.



**Varianti 3:** Në pjesën e tokave përgjatë zonës industriale në rrugën Gjilan-Bujano~~v~~c, në hamullishte ka shpërthyer zjarr. Temperaturat e larta dhe ndikimi i erës ka bërë që zjarri të përhapet me shpejtësi në drejtim të zonës industriale. Nga stihia e zjarrit në flakë janë përfshi një restorant, një fabrikë për prodhimin e betonit, një fabrikë për prodhimin e kabllove elektrik si dhe dy pika karburanti. Nga eksplodimi i njërit nga rezervarët e pikës së karburantit është dëmtuar gypi 400 mm, i cili furnizon me ujë qytetin e Gjilanit nga liqeni i Përlepnicës, ku dhe pjesa më e madhe e qytetit është mbetur pa ujë. Nga goditja e eksplodimit një person ka vdekur si dhe 7 persona kanë pësuar alivanosje si rezultat i ekspozimit ndaj dyoksidit të karbonit. Komunikacioni është ndërprerë në dy drejtimet dhe njësitet e SHZSH po bëjnë përpjekje për normalizimin e gjendjes.

## 9.2 Vlerësimi i rrezikshmërisë për vërshimet

Zonat e prirura për vërshime në Komunën e Gjilanit janë sipërfaqe të rrafshëta pranë lumenjve. Zhvillimet e fundit kanë ndryshuar shfrytëzimin e tokës nga ajo bujqësore në tokë ndërtimore. Pjesa dërmuese e sistemit të ujitjes dhe kanaleve që në një formë ishin drenazhim natyral, janë ndërprerë ose janë mbuluar duke ndërprere rrjedhën (kullimin) e ujit dhe ky është faktori i parë që ndikon në rritjen e rrezikshmërisë nga vërshimet e shtëpive dhe në të mbjellat në tokat që shfrytëzohen për bujqësi.

Faktori tjetër që ndikon në shkaktimin e vërshimeve në tTerritorin e kKomunës së Gjilanit është kryesisht për shkak të kapaciteteve të ngushtuara akumuluese të lumenjve, ndonjëherë nga punimet ndërtuese të infrastrukturës p.sh. me projektimin joadekuat të urave dhe kanaleve të kullimit.

Përmbytjet kryesisht ndodhin gjatë pranverës dhe vjeshtës. Lumenjtë dhe përroskat të cilat janë të njohura për përmbytje janë ato që rrjedhin nëpër fshatrat: Shurdhan, Pidiq, Demiraj, Zheger, Nasalë, Velekincë, Uglar,-Pogragjë [Dobërqan, Bresalc.

Si lum i madh që përshkon një pjesë të territorit të kKomunës së Gjilanit është Morava e Binçës. Ai mbledh të gjithë lumenjtë e vegjël, dhe ka një rrjedhje mesatare mujore prej 7,6 $m^3$/s. Zonat kryesore që vërshohen kohë pas kohe janë sipërfaqe të rrafshëta pranë lumit Morava e Binçës. Një ndërtesëto me gjasë mesatare për vërshim tani gjendet në komunën fqinje të Parteshit, më saktë në mes të fshatit Partesh dhe Nasalë (Sip. reth 260 ha, perimetër 8 km).

Gjatë viteve 1970, kKomuna e Gjilanit ndërmori masat e mbrojtjes nga përmbytjet të cilat ishin aplikuar për lumin Morava e Binçës me ndërmarrjen e modifikimeve në segmentet e kanalit kryesor dhe ndërtimin e mburojave në të dy anët e rrjedhës natyrore të lumit. Në këtë mënyrë fshatrat dhe toka bujqësore ishin të mbrojtur nga përmbytjet. Për më tepër, sipërfaqet përmbysëse dhe ligatinat u transformuan në tokë punuese bujqësore. Ky ishte një ndryshim dhe kontribut dramatik për zhvillimin e qëndrueshëm rural.

Zona uUrbane e qytetit të Gjilanit, gjithashtu është e ndikuar nga përmbytjet e shkaktuara kryesisht si pasojëe e një menaxhimi joefikas të shfrytëzimit të tokës

dhe mirëmbajtjes së rrjedhave ujore që si pasojë shkaktojnë përmbytjet në këto zona.
Lumenjtë dhe përroskat që rrjedhin përmes qytetit të Gjilanit janë: lumi Mirusha, Stanishorka dhe Baja. Këta tre lumenj bashkohen në pjesën lindore të qytetit, duke krijuar sipërfaqen moçalore "Zabeli" me sipërfaqe rreth 16.4 hektar

Analizat tregojnë se vendbanimet e caktuara në veri-lindje të qytetit të Gjilanit të cilat shtrihen përgjatë lumit Stanishorka kanë pasur përmbytje të shpeshta për shume vite.

*Zona përmbytëese Stanishor/ Zona Urbane Gjilan*



Identifikimi i lokacioneve për vërshime në  komunë e Gjilanit

| | Lumenjtë | Lokacioni i vërshimeve (lagja, fshati....) | Numri i banorëve ne at lokacion | Sipërfaqja e mundshme e vërshimeve | Strehimoret (objektet Shkollore etj.) | Resurset për angazhim (humane dhe teknike |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Stanishorka | Pjesa urbane e qytetit të Gjilanit pPërgjatë shtratit të lumit | 123 shtëpi banimi, oborri podrumet dhe katet përdhese | Gjatësi 1.5 km | Pikëe karburanti, obj. afariste private. Drejt. Bujqësisë Qendra e shëndetit mental, qëndrimi ditor | Tëe mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes |
| 2 | Dobrusha | Pjesa urbane e qytetit të Gjilanit Përgjatë shtratit të lumit | 130 shtëpi oborri podrumet dhe katet përdhese | Gjatësi 3 km | Një institucion parashkollor dhe një qendër e mjekësisë familjare | Tëe mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes |
| 3 | Banja | Pjesa urbane e qytetit të Gjilanit Përgjatë shtratit të lumit | 62 shtëpi | Gjatësi 1.2 km | Qendra kryesore e mjekësisë familjare | Tëe mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes |
| 4 | Morava | Fshati Nasalë | Tokë bujqësore, ara dhe livadhe | 10 hektarë | / | Tëe mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes |
| 5 | Lumi i Zhegrëes | Fshati Lladovë | 150 shtëpi dhe tokë bujqësore | 13 hektarë | / | Tëe mjaftueshme për intervenim dhe sanim të gjendjes |

| Kategoria e Rrezikut | Hidrologjike |  |
|---|---|---|
| Lloji | Fatkeqësi natyrore | |
| Rreziku | Vërshim | |
| Lokacioni: | Zonat e vërshuara – lumi“Stanishorka” dhe përroska e “Kufcës”zona Urbane - | |

**Identifikimi i rrezikut**

**Historiku**

Zonat e vërshuara janë shqetësim në këtë pjesë urbane të komunës së Gjilanit, dhe ajo është një zonë qartë e vërshuar nga lumi Stanishorka dhe përroska e Kufcës. Kjo shihet nga sondazhi i krijuar nga më shumë se 200 shtëpi të zonave të vërshuara: Qytet i vjetër dhe Kufcë e poshtme në muajt korrik dhe gusht 2009.
Për këtë pjesë të qytetit ekzistojnë PDU të Gjilanit si zona pPjesa e vjetër e qytetit-1974, me të cilein plan përfshihet zona që nga Stacioni i autobusëve e deri te kryqëzimi rrugëve te lumi Mirusha, kompleksi shkollor: deri të rruga e parë në periferi të lagjes Dheu i Bbardhë, rr; "A. Presheva", lumi Stanishor deri te stacioni i derivateve Kosova–Petrol, përballë kazermës së FSK.
Gjatë anketimit është parë se zona përgjatë lumit "Stanishorka" është e përfshirë nga vërshimet, veçanërisht gjatë sezonit të pranverës dhe vjeshtës. Vërshimet në këtë zonë janë të lidhura me reshurat,veçanërisht në pjesën veriore të komunës së Gjilanit, nga kodrat në veri të fshatit Stanishor dhe fshatin Kufca e Epërme. Vërshimet vijnë edhe nga ujërat sipërfaqësor që grumbullohen gjatë të reshurave në pjesën e majtë të zonës Qytet i Vjetër, kurse në anën e djathtë vërshohen nga lumi Stanishorit, duke dëmtuar shtëpitë nga dy anët.
Fusha e vërshuar është përdorur për bujqësi dhe shumica e përmbytjeve janë menaxhuar nëpërmjet kanaleve rreth ngastrave bujqësore duke përdorur atë për ujitje në bujqësi. Fatkeqësisht kjo njohuri u humb pas viteve 1945, dhe zona e vërshuar thjeshtë ishte ndërtuar pa kontroll (rregull) ku vazhdon edhe sot, dhe numri i ndërtesave të ngritura në të gjithë zonën është në rritje.
Pjesa më e madhe e banorëve të kësaj zone kanë njohuri rreth përmbytjes.
Nga numri i përgjithshëm i banorëve që jetojnë në Gjilan, përafërsisht 971 banorë janë në zonën e përfshirë nga përmbytjet, por ky numër ka tendencë të rritjes nga shkaku se shumë shtëpi janë në ndërtim e sipër dhe ne nuk mund të merrnim informacione.

## Vlerësimi i rrezikshmërisë

**Gjasa**




**Goditja**

| Banorë | Familje | Hendikap | Femra | Meshkuj | Fëmije | Pleq | Të mirat materiale | Infrastrukt. Kritike | Objekte te rëndësisë së veçantë | Trashëg. Kulturore | Dëmet Ekonomike (Kostoja) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 971 | | | | | | | Shtëpi banimi dhe kultura bujqësore | | Drejtoria e Bbujqësisë. Qendrae e Shëndetit mental | / | |

-Një numër i kufizuar i familjeve të goditur nga vërshimi pa fatalitete dhe pa kërkesa për hospitalizim dhe trajtim mjekësor,
-Zhvendosje e lokalizuar e një familje me kohëzgjatje prej 6 deri në 24 orë,
-Mbështetje me personel e mjaftueshme nga niveli lokal,
Kontaminim i thjeshtë i ujit, efekti i lokalizuar shpejt,
Funksionimi normal i komunitetit.

**Pasojat**

- Dëmtim i pajisjeve dhe orendive të shtëpisë
- Dëmtim i ushqimit (miellit ,dhe produkteve tjera)
- Dëmtim i tokës bujqësore me kultura vjeshtore (grurë, elb dhe sipërfaqe tjera)
- Dëmtim i rrugëve të rendit të IV

| | |
|---|---|
| **kenarët e mundshëm** | Gjatë 24 orëve të fundit nga reshjet e shiut të shoqëruara edhe me shkrirje të borës ka ardhure deri te ngritja e nivelit të lumit përroskës “Stanishorka” në këtë lokacion duke shqetësuar banorët pasi që nga  enti meteorologjik parashihet që edhe në ditët në vijim të ketë të reshura me intensitet të shtuar:<br>- **Varianti 1**: p~~P~~ërmbytja e oborreve dhe bodrumeve  që për pasoj implikon marrjen e masave për largimin me kohë të pajisjeve dhe gjësendeve shtëpiake pa pasoja për infrastrukturën kritike dhe objekte të rëndësisë së veçantë<br>- **Varianti 2**:v~~V~~ërshimi i hapësirave të banimit në shtëpitë përdhese (përafërsisht në nivel me tokë) me mundësi që për shkak të vërshimit të zhvendosen përkohësisht banorët e shtëpive deri sa zgjatë vërshimi apo edhe të evakuohen banorët e 6 shtëpive përdhese në nivel me tokë dhe marrja e masave për strehimin  e rreth 35 veta. Për shkak të mundësisë së depërtimit të ujërave të zeza në rrjetin e ujësjellësit dhe infeksionet e mundshme d~~D~~rejtori i Drejtorisë për Mbrojtje dhe S~~s~~hpëtim, kërkon nga Instituti Rajonali i Shëndetit Publik dhe nga Kompania Rajonale për Ujësjellës Hidromorava që të bëhet kontrollimi i ujit dhe nëse ka shenja kontaminimi të bëhet ekzaminimi i rasteve që kërkojnë trajtim medicinal.<br>- **Varianti 3** :s~~S~~ituata është shumë e përkeqësuar pasi që reshjet vazhdojnë me intensitet edhe më të shtuar, banorët janë në panik sepse uji ka filluar të depërtoj në thellësi të objekteve të banimit duke dëmtuar në masë të madhe pajisjet shtëpiake. Në afërsi te kazerma e FSK dy fëmijë kanë rë~~e~~në nga ura dhe për fatin e tyre nuk dihet pasi janë bartur nga vala vërshuese e ujit dhe njësit e kërkim-shpëtimit janë vënë në veprim për gjetjen e tyre. Janë lajmëruar edhe 6 raste të helmimit nga ndotja e ujit, ndërsa qarkullimi nga qendra~~e~~ e qytetit në~~e~~ drejtim te fshatit Malishevë, Kufcë e Epërme dhe është ndërprerë. Nga vlerësimi i zyrtareve të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim rezulton se rreth 60 duhet të evakuohen. |

## 9.3 Vlerësimi i rrezikshmërisë për shtrëngata dhe breshër

Në territorin e komunës Gjilanit, shtrëngatat dhe breshëri janë dukuri e rrallë natyrore. Paraqitja e tyre me intensitet të ulët më së tepërmi ndodhë në pranverën e hershme dhe në vjeshtë. Rastet e paraqitjes së shtrëngatave dhe breshrit me intensitet të mesëm dhe të lartë janë të kohë-paskohshme edhe muajve të verës.



**Pullaze shtëpish të dëmtuara gjatë shtrëngatës të vitit 2009**

Shtrëngatat të shoqëruara breshër në rend të parë reflektohen në rrezikimin e sigurisë së qytetarëve, dëmtimin e shtyllave elektrike dhe rrjetit të saj, rrjetin e telefonisë fikse dhe mobile, dëmtoni i pullazeve, dëmtimi i shtëpive nga materiali i dobët si dhe zhvendosjen e gjësendeve të forta e metalike të pa përforcuara e të cilat mund të rrezikojnë jetën e qytetarëeve dhe kalimtarëve të rastit etj. Shtrëngatat dhe breshëri dëmet më të mëdha i shkaktojnë në sektorin e bujqësisë.

Nëe dhjetë vjetshin e fundit, goditja më e rënd nga kjo fatkeqësi natyrore ka ndodhur me 24.05.2009. Rreth orës 15:20, një shtrëngatë e shoqëruar me breshër ka goditur pjesën veriperëndimore, perëndimore, qendrore, jugperëndimore dhe pjesërisht pjesën jugore të qytetit të Gjilanit. Në intervalin kohor 10 deri në 15 minuta sa ka zgjatur kjo shtrëngatë, përpos panikut, ka arritur të shkaktoj dëme të konsiderueshme në lagjet e qytetit: një pjesë të lagjes Dheu i Bardhë, Dardaninë, Qendra 1, Qendra 2, Kodrën e Dëshmorëve, Qarkun, pjesërisht lagjen Arbëria, pjesërisht fshatin Livoq i Pposhtëm, pjesërisht fshatin Livoq i Eepërm dhe pjesërisht fshatin Velekincë

Sipas Komisionit mbi Dëmet e sShkaktuara të emëruar nga kKryetari i Komunës dëmet nga kjo fatkeqësi janë si më poshtë:

| | Sektorët e dëmtuar | Ek. Familjare Nr. | Tjegulla | Xhama m² | Fasada m² | Vetura | Trupa të pemëve | Kopshte m² | Vlera € |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ek. familjare | 6.205 | 2.236.856 | 5.009 | 27.816 | 1.691 | 38.402 | 14.6985 | 2.128.464 |
| 2 | Banesa kolektive | | | | | | | | 105.160 |
| 3 | Shëndeti primar | | 5.300 | | | | | | 2.120 |
| 4 | Spitali regjional | | | | | | | | 60.000 |
| 5 | Bujqësia | | | | | | | | 1.280.508 |
| 6 | Biznesi | | 79.653 | 152 | 370 | 47 | | | 41.021 |
| Σ | | 6.205 | 2.321.809 | 5.161 | 28.186 | 1.738 | 38.402 | 146.985 | 3.617.274 |

| | |
|---|---|
| **Kategoria e rrezikut** | **Meteorologjike** |
| **Lloji** | **Fatkeqësi natyrore** |
| **Rreziku** | **Shtrëngatë dhe breshër** |
| **Modeli** | **Jo sezonal** |
| **Lokacioni:** | **I papërcaktuar** |

**Historiku**

Territori i komunës i nënshtrohet ndikimeve të ajrit dhe si rezultat janë shkaktuar dëmtime të konsiderueshme në infrastrukturë.

Situatë më serioze kemi pasur në korrik të vitit 2009, ku nga pasoja e shtrëngatës dhe breshëritë janë dëmtuar pullazet e shtëpive dhe banesave kolektive, serat, sipërfaqet bujqësore, veturat dhe automjetet transportuese. Lëndime të njerëzve nuk ka pas, ndërsa dëmet materiale vlerësohen relativisht të mëdha dhe kryesisht tek objektet e banimit dhe në sektorin bujqësor. Fatkeqësi të këtij niveli në këtë dhjetëvjeçarin e fundit nuk kemi pasur, mirëpo mundësitë e përsëritjes janë permanente.

Intervenimet për situata të tilla janë afatshkurtra max.12 orë, dhe imponojnë ndërhyrje të specializuar.

**Gjasat**



| | Banorë | Familje | Hendikap | Femra | Meshkuj | Fëmije | Pleq | Të mirat materiale | Infrastrukt. Kritike | Objekte te rëndësisë së veçantë | Trashëgim. Kulturore | Dëmet Ekonomike (Kostoja) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Goditja** | 15.000 | 3300 | | | | | | Pullaze. Objektet montazh. Sera dhe sipërfaqe bujqësore. | Shtylla elektrike Antena të telefonisë | / | / | 3.617.274 € |

Fataliteti i vetëm, një numër i kufizuar i njerëzve të goditur nga breshëri dhe nga paniku, disa të hospitalizuar kërkohet trajtim mjekësor
Mbështetje profesionale e mjaftueshme nga niveli lokal
Ndërprerje e përkohshme e energjisë elektrike, (nga lidhja e shkurtër) defekti i lokalizuar shpejt,
Funksionim normal i komunitetit

**Pasojat**

Dëmet e shkaktuara në këtë drejtim janë:

- dDëmtimi i objekteve të banimit, (pullazeve, dritareve dhe fasadave)
- dDëme në objekteve bujqësore (sera dhe plantazhe)
- pPasoja në biznese dhe turizëm (punëtori, zyra dhe makineri).

**Skenarët e mundshëm**

**Varianti 1:** r~~R~~reth orës 14,30 nga një qytetar i lagjes Dardania, përmes 112 lajmëron se nga një stuhi e fortë në këtë pjesë të qytetit janë rrëzuar 3 shtylla elektrike dhe 5 të tjera telefonike duke bllokuar 3 nyje~~j~~ rrugore që kalojnë nëpër këtë lagje, ndërsa si pasojë janë lënduar 3 kalimtar nga bartja e gjësendeve të ngurta nga ana e erës së fort dhe janë thyer xhamat 13 lokaleve afariste. Me këtë rast lajmërohen se dy prej të lënduarve janë në gjendje të rëndë të cilëve iu nevojitet transport urgjent në qendrën spitalore të qytetit. Policia është në vendngjarje duke bërë sigurim e perimetrit të zonës së incidentit. Nga një shtyllë e rrëzuar elektrike është shkaktuar zjarr në një lokal afarist nga përhapja e të cilit rrezikohen lokale të tjera afariste dhe shtëpi banimi. Zyrtarët në vendin e incidentit, njoftojnë SHZSH që menjëherë të dërgojnë një ekip për fikjen e zjarrit kurse përmes 112, kërkojnë që në vendin e incidentit të dërgohet auto ambulancat dhe ekipet e KEK-ut. Në këtë pjesë të qytetit qarkullimi i njerëzve dhe automjeteve është ndërprerë në interval kohorë 3-6 orë, zëdhënësi i KEK-ut deklaron për 6-8 orë do të zgjatë riparimi i rrjetit elektrike, ndërsa SHZSH në afat prej 45 minutash arrijnë të shuajnë zjarrin. Dëmet materiale janë të konsiderueshme.

**Varianti 2:** s~~S~~i pasojë e stuhisë së madhe janë rrëzuar 3 largpërçues në drejtimi të Kamenicës dhe si pasoj gjithë regjioni i Kamenicës ka mbetur pa energji elektrike dhe pa ujë të pijes. Në mungesë të ujit disa familje kanë filluar të përdorin puset shtëpiake që për pasoj kemi 21 persona të infektuar nga uji i ndotur dhe kërkojnë ndihmë mjekësore. QMF është angazhuar për trajtimin e këtyre të infektuarve ndërsa 2 prej tyre duhet të barten në Spitalin regjional të Gjilanit. KEK-u konfirmon se riparimi i rrjetit dhe trafo~~-~~stacioneve në linjë do të zgjatë deri në 5 ditë, ndërsa qytetarët e kësaj zone lajmërojnë për dëme të konsiderueshme në amvisëri dhe biznese individuale. Policia në vendngjarje monitoron zonën e incidentit, ndërsa SHZSH është në gjendje gatishmërie për çdo eventualitet.

**Varianti 3:** n~~N~~ga era e fuqishme përmes 112 janë lajmëruar raste të shumta të rrëzimit të shtyllave elektrike, lisa të mëdhenj, çati metalike dhe druri, reklama, objekte të improvizuara etj. Situata është kritike sidomos përgjatë rrugës kryesore ku ka shumë shtylla, lisa dhe gjësende tjera që kanë bllokuar rrugën. Situata është alarmante pasi që si pasojë e rrëzimit të një lisi të madh kanë pësuar dy kalimtarë të rastit të shoqëruara me dëme materiale në vetura, ndërsa në rrugën e Prishtinës lajmërohen për dëmtimin e një çatie të një ndërtese 4 katërshe duke lënë të vdekur një persona dhe 5 tjerë me lëndime të rënda, të cilët ishin në pritje të transportit për në Prishtinë. Si pasojë e shtrëngatës nga rrëzimi i përçuesve të tensionit të lartë në pjesën verilindore të qytetit mbi garazhet e një firme private të ndërtimit shpërthen një zjarr i madh dhe një kalimtar i rastit merr plagë vdekjeprurëse nga rryma. Përmes 112 qytetarët lajmërohen për shumë raste të lëndimeve të lehta dhe të rënda, dhe dëme nga shtyllat, lisa dhe gjësendet tjera të rrëzuara. Komiteti komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe gjitha strukturat kanë mobilizuar ekipet e zjarrfikëseve, policinë, shërbimet medicinale, kompanitë publike dhe private dhe kompanitë aktuale tenderuese të infrastrukturës të cilat në afat rekord kanë dalë në teren për kryerjen e detyrave të kërkim-shpëtimit, duke u vënë në përpjekje për sanimin e gjendjes secila në kuadër të fushë veprimtarisë së tyre. Policia ka mobilizuar të gjithë personelin për vënien e rendit dhe funksionimin e qarkullimit në rrugët alternative dhe parandalimin e dukurive e vjedhjeve të dyqaneve si pasojë e kaosit të krijuar në qytet, ndërsa zjarrfikësit janë angazhuar në shuarje të zjarreve të shkaktuara nga efekti i rrymës. Meda~~ie~~t pandërprerë janë duke sensibilizuar qytetarët për dhurim të gjakut për shkak të numrit enormë të lënduarve. Ndihmesë vendimtare në këtë sensibilizim po jep Kryqi i Kuq i Komunës.

## 9.4 Vlerësimi i rrezikshmërisë për tërmet

Dihet se në pikëpamje sizmologjike, Kosova paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrat të cekëta, gjenerojnë në koren e tokës, maksimum 15 – 20 km thellë në tokë

Territori i Kosovës ka disa zona të burimeve sizmike, si vijon:

| | **Zona zeizmike** | **Shkalla e goditjes** |
|---|---|---|
| 1 | Zona sizmike Prizren-Pejë | magnitude maksimale M=6.6 shkalla Riter |
| 2 | Zona sizmike Ferizaj-Viti – Gjilan | magnitude maksimale M=6.1 shkalla Riter dhe |
| 3 | Zona sizmike Kopaonik | magnitude maksimale M=6.0 shkalla Riter |

Këto zona të burimeve sizmike në Kosovë kanë gjeneruar në të kaluarën dhe mund të gjenerojnë edhe në të ardhmen termeite të fortë.

Ndër tërmetet më të fuqishme që kanë goditur Kosovën, këtu po përmendim:

-Tërmetin e Prizrenit, më 16 qershor 1456, me intensitet në epiqendër I0=9 ballë shkalla MCS dhe magnitudë 6.6 shkalla Rihter,
-Tërmetin e Pejës, më 11 nëntor 1662, me intensitet në epiqendër I0=8 ballë shkalla MCS dhe magnitudë 6.0 shkalla Rihter,
-Tërmetin e Ferizajt, më 26 shkurt 1755, me intensitet në epiqendër I0=8 ballë shkalla MCS dhe magnitudë 6.1 shkalla Rihter,
-Tërmetin e Ferizajt – Vitisë, më 10 gusht 1921, me intensitet në epiqendër I0=9 ballë shkalla MCS dhe magnitudë 6.1 shkalla Rihter,
-Tërmetin e Kopaonikut,më 18 maj 1980, me intensitet në epiqendër I0=8 ballë shkalla MCS dhe magnitudë 6.0 shkalla Rihter,
Territori i Kosovës, gjatë shekullit të kaluar e deri më tash është prekur nga 64 tërmete me intensitet 5 ballë, nga 30 tërmete me intensitet 6 ballë, nga 12 tërmete me intensitet 7 ballë, nga 8 tërmete me intensitet 8 ballë (1 termet i përket periudhës para vitit 1900) dhe nga 3 tërmete me intensitet 9 ballë (2 tërmete i përkasin periudhës para vitit 1900)

Shënojmë se rRajoni Ferizaj-Gjilan është prekur nga dy tërmete shumë të forta, më 1755 dhe 1921. Tërmeti i vitit 1921, me të njëjtin intensitet prej 9 ballë me atë të vitit 1755, çka do të thotë se është përsëritur këtu pas 166 vjetësh.

Tërmeti i vitit 1921 është shoqëruar nga shumë peasë goditje të forta 7 e 8 ballë shkalla MCS, që kanë zgjatur për një vit, nga gushti 1921 deri më shtator 1922

Karakteristike është se në rajonin Ferizaj-Gjilan janë regjistruar tërmetet me magnitudë nën 5.0 shkallë të Riterit dhe intensitet në epiqendër rreth 6–7 ballë, me sa vijon:

- Tërmeti i 5 marsit 1936 me magnitudë 4.9 dhe intensitet në epiqendër 6-7 ballë
- Tërmeti i 8 qershorit 1956 me magnitudë 4.6 dhe me intensitet në epiqendër 6 ballë.

Nga kjo shihet se pas vitit 1956 nuk është regjistruar ndonjë termet me intensitet në epiqendër 6 ose mbi 6 ballë. Dhe vetëm më 24 prill 2002 një termet me intensitet në epiqendër prej 7.5 ballë MSK-64 goditi rajonin e Gjilanit.

Nga kjo konstatojmë se ky termet është përsëritur këtu pas 46 vitesh nga tërmeti 6 ballësh i vitit 1956 dhe pas 66 vitesh nga tërmeti 6-7 ballësh i vitit 1936.

Nga kjo që u tha më sipër rrjedh se territori i Kosovës paraqet një vend nga pikëpamja sizmike aktive e me rrezikshmëri sizmike të lartë, njëlloj si vendet fqinje me të.

Sizmiciteti i lartë i Kosovës dhe tërmeti i 24 prillit 2002, që preku r~~R~~ajonin e Gjilanit, sikur edhe tërmetet e kohë pas koh~~b~~shme të cilat ndodhin në vazhdimësi duhet të evidentohet si çështje e dorës së parë, e cila kërkon zgjedhje të nevojave urgjente për ngritjen e shërbimeve sa më të mira emergjente për tejkalimin e situatave të tilla.




**Harta. 4: Harta e zonave maksimalisht të rrezikuara nga tërmetet në Kosovë gjatësia dhe gjerësia gjeografike**

Bazuar në raportin e zyrës për sizmologji nga Instituti Sizmik Kombëtar shohim se:

**ZYRA PËR SIZMOLOGJI**




***Raporti Vjetor 2008***

Duke u bazuar në të dhënat e Rrjetit Sizmologjik të Kosovës , EMSC dhe Rrjeteve Sizmologjike të vendeve të Rajonit, Zyra për Sizmologji, gjatë kësaj periudhe ka bërë monitorimin e ngjarjeve sizmike, regjistrimin si dhe përpunimin e parametrave të tërmeteve në vend dhe rajon.

Gjatë kësaj periudhe vjetore kanë ndodhur 214 tërmete, 151 tërmete kanë qenë të rajonit, ndërsa 63 tërmete në Kosovë. Vetëm në Komunën e Gjilanit kanë ndodhur 20 tërmete pra 1/3 edhe atë: 1.5 deri 2.5 shkallë 15, prej 2.5 deri 3.5 shkallë 3 dhe prej 3.5 deri në 4.4 shkallë 2 tërmete.

**DIAGRAMI I TËRMETEVE 2008**



# HARTA E EPIQENDRAVE TË TËRMETEVE 2008




III -- 1.5-2.5
IV -- 2.5-3.5
V -- 3.5-4.4




Fig. Shperndarja e nxitimit maksimal ne territorin e Kosoves per truall mesatar, periudha e perseritjes 500 vjet .



Harta e intensiteteve maksimale për terr. e Kosovës për vitin 2008

Bazuar në raportin e zyrës për sizmologji nga Instituti Sizmik Kombëtar për vitin 2009 shohim se:

## DIVIZIONI PËR SIZMOLOGJI




## SIZMICITETI I KOSOVËS-2009

Duke u bazuar në të dhënat e Rrjetit Sizmologjik të Kosovës si dhe në bashkëpunimin, respektivisht shkëmbimin e të dhënave për aktivitetin sizmik me institucionet relevante në rajon, Evropë dhe më gjerë, personeli i Divizionit për Sizmologji për vitin kalendarik 2009 ka realizuar mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe analizimin e të dhënave sizmologjike.
Në bazë të dhënave të Rrjetit Sizmologjik të Kosovës, të Qendrës Sizmologjike EURO-MEDITERANE, si dhe vendeve të rajonit, Divizioni për Sizmologji regjistroi aktivitet mesatar sizmik në territorin e Kosovës. Gjatë kësaj kohe, në këtë hapësirë u evidentuan tërmete me magnitudë **$1.0 \leq M \leq 3.8$**

Tërmetet e evidentuara gjatë vitit 2009 për territorin e Kosovës, janë treguar në hartën e epiqendrave. Dendësia e tërmeteve gjatë vitit 2009 mund të shikohet nga diagrami i numrit të tërmeteve sipas muajve.

**DIAGRAMI I TËRMETEVE NË KOSOVË 2009**




**Harta e epiqendrave të tërmeteve në Kosovë - 2009**




III --- 1.5-2.5

IV --- 2.5-3.5

V --- 3.5-4.4




**Epiqendrat e tërmeteve të ndodhura në Komunën e Gjilanit**




**Harta e zonës sizmike**




**Harta tektonike**

| Kategoria e Rrezikut | Tektonike |
|---|---|
| Lloji | Fatkeqësi natyrore |
| Rreziku | Termet |
| Lokacioni: | Gjilan zona -Urbane |



50vj. Harta e Zoonimit Sizmik zoonimit Sizmik



- 100vj. Harta e

**Identifikimi i rrezikut**

**Historiku**

Dihet se në pikëpamje sizmologjike, Kosova paraqet një rajon me aktivitet sizmik të lartë, i cili është goditur në të kaluarën dhe mund të goditet edhe në të ardhmen nga tërmete autoktone shumë të fortë, të cilët i kanë vatrat të cekëta, gjenerojnë në koren e tokës, maksimum 15 – 20 km thellë në tokë

Territori i Kosovës ka disa zona të burimeve sizmike

Zona sizmike Prizren – Pejë me magnitude maksimale M=6.6 shkalla Riter

Zona sizmike Ferizaj – Viti – Gjilan me magnitude maksimale M=6.1 shkalla Riter dhe

Zona sizmike Kopaonik me magnitude maksimale M=6.0 shkalla Riter

Të mërkurën më, 24 prill 2002 në 12:51 më orë lokale, një tërmet ka prekur rajonin e Gjilanit. Sipas Instituti Sizmologjik i Serbisë, shkalla paraprake e tërmetit është ka qenë 5.1, me epiqendër e tij rreth 175 milje në jug të Beogradit, afër qytetit të Vitisë, Kosovë

Sipas Qendrës Sizmologjike të Evropës Mesdhetare (EMSC) tërmeti është lokalizuar në gjerësinë 42,40 N dhe lartësinë 21,40 E të tërmeteve. Thellësia qendrore e tërmetit u vlerësua në rreth 10 km, dhe magtituda ML = 5.4.

Si pasojë e këtij tërmeti në Gjilan, një njeri eu humbi jetën nga rënia e një objekti të fortë (tullë) që kishte rënë nga lartë, kurse mbi 60 persona u plagosën. Një minare e xhamisë u shemb. Dëmet strukturore u njoftuan për objektet me mur masiv (guri / tulla) ndërsa në ato të sistemet RC u shfaqen kryesisht dëme jo strukturale në pjesët e mureve ndarëse dhe në fasadë. Në përgjithësi, modelet e dëmit nga tërmeti korrespondojnë intensitetit me shkallën e intensitetit sizmik I = VII në EMSC-98. Dukuri të tillë një për një tërmet në zonën e Vitisë nuk është e habitshme. Potenciali sizmik i zonës është njohur në mënyrë të qartë dhe ndikimi i saj është i përfshirë rregullisht në analizat rajonale të rrezikut sizmik. Kapaciteti i energjisë së tij i cili i korrespondon përcaktimit rajonal tektonik dhe në përputhje me historikun e tërmeteve të regjistruara (1921, Io=IX0 në shkallë të intensitetit sizmik MCS), është vlerësuar në magnitudë M=6,5 në shkallën Rihter (pritet MSK-64 I=intensiteti i IX0 për periudhën e kthimit 500 vjet).

Për më tepër në: "Vlerësimin e rrezikshmërisë nga tërmeti" shkollat dhe entet parashkollore nga DMSh dhe UN-Habitat( me angazhimin e IIS-Shkup) korrik-gusht/ 2009, projekti përfundimtar janar 2010/2011.

## Vlerësimi i rrezikshmërisë

### Gjasa




### Goditja

| Banorë | Familje | Handikap | Femra | Meshkuj | Fëmije | Pleq | Të mirat materiale | Infrstrukt Kritike | Objekte te rëndësisë së veçantë | Trashëg. Kulturore | Dëmet Ekonomike (Kostoja) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 90.015 | 17.048 | | 44.692 | 45.323 | | | 7.021 Shtëpi banimi, banesa | Rrjeti i ujësjellësit, energjetik, | | | 81.000.000.€ |

- Një numër i kufizuar i i personave të goditur nga tërmeti pa fatalitete por me kërkesa për hospitalizim dhe trajtim mjekësor
- Evakumi nga objektet shkollore me kohëzgjatje prej 24 deri në 48 orë,
- Mbështetje me personel e mjaftueshme nga niveli lokal,
- Dëme të pjsëshme në objekte shkollore kryesishtë në fasadë dhe disa plasje në gypat e ujit,efekti i lokalizuar shpejt,
- Funksionimi normal i komunitetit.

### Pasojat

- Dëmtim i pajisjeve dhe orendive të ekonomive familjare, shkollave dhe institucioneve
- Dëmtim të pjesshëm të shtëpive të banimit dhe objekteve të institucioneve publike.
- Dëmtim i rrjetit të ujësjellësit

| Skenarët e mundshëm | |
|---|---|
| | **Skenari- I** |
| | **Skenari -II** |
| | **Skenari -III** |



## 9.5 Vlerësimi i rrezikshmërisë për erozion

Erozioni është një proces natyror, i cili në masë të madhe ndikohet nga aktiviteti njerëzor. Shfrytëzimi i tokës në komunën e Gjilanit, shpyllëzimi dhe shtrirja urbane kanë ndikuar në ngritjen e shkalles së erozionit. Përmirësimi i praktikave të shfrytëzimit të tokës mund të kufizojëe erozionin duke rekomanduar sistemet ndërtimore, pyllëzimin dhe shtrirjen e kontrolluar të zgjerimit të vendbanimeve.
Komuna e Gjilanit nuk karakterizohet me shkallë të lartë të erozionit. Territori i identifikuar me shkallë të lartë të erozionit (afërsisht 9 % të territorit të komunës) gjendet në pjesën veriore dhe jugore të territorit.

| Nr | **Përshkrimi** | **Sipërfaqja** |
|---|---|---|
| 1 | Erozion shumë i ulët | 7% |
| 2 | Erozion i ulët | 53% |
| 3 | Mesatar | 31% |
| 4 | I lartë | 9% |

## 9.6 Vlerësimi i rrezikshmërisë për Thatësira

Thatësira dhe temperaturat e larta ndikojnë në zvogëlimin e furnizimit të banorëve me ujë të pijes, ku për shkak të konsumit të madh gjatë stinës së verës ekziston mundësia e reduktimeve që për pasoj kanë mundësin e shfaqjes së sëmundjeve epidemiologjike. Sipas të dhënave nga Enti Epidemiologjik deri më tani nuk kemi pas dukuri epidemiologjike si pasoj e mungesës së ujit .
Ndikimi i thatësisë në prodhimtarin bujqësore
Thatësia, përveç ndikimit në zjarre dhe dëmeve të shkaktuara në pyje, ndikim kryesor ka edhe në prodhimtarin e kulturave bujqësore sidomos në zvogëlimin e rendimenteve në lavërtari, pemëtari, vreshtari etj, me ç'rast në zonat ku nuk ka ujitje (zonat malore) rendimenti është për 60 % më i vogël.

# 10.0 Fatkeqësitë tekniko-teknologjike

## 10.1 Vlerësimi i rrezikshmërisë nga depot e materialeve të rrezikshme

## 10.2 Vlerësimi i rrezikshmërisë për zjarre industriale

Ky lloj rreziku është potencial në ndërmarrjet dhe kompanitë të cilat merren me shitjen dhe transportin e derivateve të naftës dhe gazit, apo ndërmarrjet që përdorin këtë energji në procesin e prodhimit. Aktualisht ekonomia e Gjilanit e cila ka qenë pronë shoqërore dhe e cila ka qenë shfrytëzuese më e madhe e lëndëve të rrezikshme është jashtë funksionit dhe nuk paraqet rrezik nga aspekti teknologjik.

Rrezik të përmasave më serioze paraqet numri i madh i pikave që tregtojnë naftën dhe derivatet e saj që në territorin e komunës janë gjithsejtë 42 prej të cilave në pjesën urbane të qytetit janë 9, copë dhe atë: një në zonën e parë urbane; dy në zonën e dytë urbane; një zonën e tretë; dhe pesë në zonën e katërt urbane. Këto pika të shitjes së karburantit rrezikojnë drejtpërdrejtë banorët dhe pronën për shkak të dendësisë së madhe dhe objekteve të infrastrukturës përreth. Rreziku bëhet edhe më kërcënues nga fakti se shtatë nga këto merren edhe me tregtimin gazit propan-butan.

Edhe pse shumica e këtyre subjekteve te cilat merren me këtë veprimtari, nga aspekti i mbrojtjes nga zjarri dhe eksplodimet kanë plotësuar kriteret e parapara mbrojtëse-teknike dhe të trajnimit profesional të personelit, ato vazhdojnë të jenë objekte që prezantojnë rrezikshmëri të lartë meqenëse dendësia e banorëve dhe objekteve individuale dhe kolektive janë në perimetrin e zonës së rrezikut të lartë.

**Pikat e karburantit në Komunën e Gjilanit:**

| Emri | Pronari | tel | Kapaciteti i rezervarëve të naftës – benzinës në litra (l) | Kapaciteti i rezervarëve të gazit | Adresa |
|---|---|---|---|---|---|
| Kamberi-Petrol | Bejtush Kamberi | 0280/ 329 958 | 40.000 l x1. 50.000. l. x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë te rruga e Poneshit |
| Abad-Petroll | Adem Demaj | | 50.000 l x1. 50.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë, fshati Bresalc, lagjja Mehir |
| Euro-Prokom | Faredin Muji | | 30.000 l x1. 30.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë, fshati Bresalc, lagjja Mehir |
| Vullkan | Enver Ahmeti | | 50.000 l x1. 25.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë,fshatin Parallovë |
| Compakt | Saqip Shala | | 100.000 l x1 50.000. l x2 | 20m³ | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë, fshati Pasjak |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Ferizi-Petroll | Ekrem Behluli | 044 154 177 | 100.000 l x1 50.00. l x2 | 20m³ | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e djathtë, fshati Pasjak |
| Calabria | Xhelal Selimi | 044 130 946 | 90.000 l x1 50.000. l x3 | | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e djathtë |
| Al-petroll | Shabi Shabani | 044 133 148 | | | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e djathtë |
| Al-petroll-2 | Hajrulla Ameti | 044 116 918 | 50.000 l x1. 50.000. l x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë, te kryqëzimi i qarkores, Rr:"Nëna Terezë |
| Trans-shped | Nijazi Starabaja | 044 131 482 | 50.000 l x1. 50.000. l x2 | | Rruga qarkore Prishtinë-Ferizaj, ana e djathtë, Rr: "Ramiz Cërernica" |
| Albi-Petroll | Mizafer Rexhepi | 044 178 305 | 40.000 l x1. 20.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Ferizaj, afër rrugës së Budrigës së Poshtme, ana e djathtë |
| Euro-Petroll | Bekim Shkodra | 044 112 094 | | 10m³ | Rruga Gjilan-Ferizaj, ana e majtë |
| Bujana-Petroll | Enver Shabani | 044 127 663<br>044 136 724 | 50.000 l x1. 50.000. l x2 | 10m³ | Rruga Gjilan-Ferizaj, ana e majtë, Rr:"Idriz Seferi" |
| Kosova-Petroll | Rahim Demi | | 80.000 l x1 30.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Ferizaj, ana e djathtë, Rr:"Idriz Seferi" |
| Ardhmëria | Enver Zeneli | 0280 26 307<br>044 125 743 | 60.000 l x1. 60.000. l x1 30.000. l x1 | 5m³ | Rruga Gjilan-Pogragjë, fshati Malishevë, ana e djathtë |
| Alba - Petroll | ~~Bexhet Mehmeti~~ | ~~044 177 202~~ | 100.000 l x1. 50.000. l x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Pogragjë, fshati Malishevë, ana e majtë |
| Lirimi | Bajram Demiri | 044 280 493 | 21.000 l x1. 25.000. l x2 | | Pronë e "Agrokulturës", fshati Zhegër - në shfrytëzim privat |
| Dritoni-Petroll | Osman Islami | 044 176 914 | 50.000 l x1. 50.000. l x2 | 5m³ | Në hyrje të fsh. Lladovë në anën e majtë |
| Rekord-As | Isuf Mustafa | 0280 321 149<br>044 125 909 | 25.000. l x1. 25.000. l x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Preshevë,lagjja "Arbëria" ana e majtë,Rr:"Lidhja e Prizerenit" |
| Tërnovci benz | Shaban Kurteshi | 044 132 788 | 50.000. l x1. 50.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e majtë |
| Bini | Xhevat Bunjaku | 044 169 557 | 25.000. l x1. 25.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e majtë |
| Burimi petroll | Shukri Rexhepi | 044 250 240 | 50.000. l x1. 50.000. l x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e djathtë |
| Kamberi benz | Sabri Kamberii | 0280 324 909<br>044 154 514 | 50.000. l x1. 50.000. l x2 | | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e djathtë |
| Arbëri-M | Driton Latifi | 044 132 788 | 50.000. l x1. 50.000. l x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e majtë |
| Mireshi | Zija Salihu | 044 343 007 | 58.000. l x3. 57.000 l x1 | 5m³ | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e majtë |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Beki benz | Agim Hoti | 044 154 165 | 25.000 l x1. 25.000 l x2 | 5m³ | Rruga Gjilan-Kamenicë, ana e majtë |
| Xhelali-Petroll | Faruk Dauti<br>Bekim Dauti | 044 178 333 | 60.000 l x1. 50.000 l x2 | 10m³ | Në dalje të fsh. Velekincë, ana e majtë |
| Ada-gas | Avdulla Murati | 0280 325 463<br>044 141 780 | 25.000 l x1. 25.000 l x2 | 100m³ | Rruga qarkore afër „Gllamës |
| Kosova-Petroll 2 | Refik Osmani | 04 144 368 | 46.000 l x1. 40.000 l x2 | | Gjilan, te kazerma, në anën e majtë |
| Shaqa petroll | Haki Shaqiri | 044 322 414 | 60.000 l x1. 50.000 l x2 | | Gjilan – Ferizaj, në anën e majtë Rr:"Idriz Seferi |
| Gani- petrol | Fevzi Hajrullahu<br>Nijazi Hajrullahu | 0280 328 550<br>044 628 251 | 60.000 l x1. 60.000 l x2 | 5m³ | Në dalje të fsh. Velekincë, ana e djathtë |
| Gas-com-petrol | Muharrem Murati | 044 141 797 | 15.000 l x1. 15.000 l x1 | 5m³ | Gjilan – Prishtinë, ana e majtë në dalje të qytetit-brenda qarkores,Rr:"Nëna Terezë" |
| Ri-com-petrol | Rifat Musliu | 044 231 111 | 60.000 l x1. 60.000 l x2 | 30m³ | Gjilan-Ferizaj, ana e djathtë në dalje të qytetit-brenda qarkores,Rr:"Idriz Seferi" |
| Agmia-petroll | Bejtulla Xhelili | 044 761 791 | 30.000 l x1. 30.000 l x1 | 10m³ | Gjilan – Bujanoc, ana e majtë, në hyrje të "AGMISË",Rr:"Marije Shllaku" |
| Dema petroll | Rexhep Sejdiu | 044 154 093 | 40.000 l x1. 30.000 l x1 | 10m³ | Rruga Gjilan-Shurdhan, në dalje të Zhegrës ana e majtë. |
| Vullkan | Enver Ahmeti | | | | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e djathtë |
| Petrol company | | | 40.000 l x1. 40.000 l x1 | 5m³ | Rruga:Gjilan - Prishtinë,ana e djathtë pas qarkores |
| Dulaku petroll | Habib Muji | 044 317 567 | 15.000 l x1. 20.000 l x1 | 5m³ | Rruga Gjilan-Prishtinë, ana e majtë,fshati Bresalc |
| OLT petroll | Ismajl Latifi<br>Skender Latifi | 044 479 704 | | | Rruga Gjilan - Pogragjë në hyrje të fsh. Uglar ana e djathtë |
| Petroll-company | | 044 574 894 | 30.000 l x1. 30.000 l x1 | | Rruga: Gjilan - Bujanoc në dalje të qytetit brenda qarkores ana e majtë |
| "ABN-petroll" | Lulzim Bajrami | 044 132 707 | | 5m³ | Rruga: Gjilan – Bujanoc në hyrje të Doberqanit ana e majtë |
| PULS-oil | Milenkoviq Cvetko | 064 8022909 | 15.000 l x1. 15.000 l x1 | 5m³ | Në hyrje të fsh. Shillovë ana e djathtë |

| | |
|---|---|
| **Kategoria e rrezikut** | **Tekniko-teknologjike** |
| **Lloji** | **Objekt ekonomik** |
| **Rreziku** | **Eksplodim-zjarr** |
| **Modeli** | **Jo sezonal** |
| **Lokacioni:** | **Kosova petrol -2** |

**Historiku**

Kjo pikë karburanti gjendet në rrugën "Avdulla Tahiri" përball kazermës së FSK. Ka kapacitet të rezervarëve 1 X 46.000, dhe 2 X 40.000 litra. Paraqet rrezikshmëri për rrethinën pasi në afërsi të saj është krijuar zonë e dendur e banimit dhe ka rritje të fluksit të makinave dhe qytetarëve.

-Në afërsi deri në 20 metra nga rezervarët e kësaj pike karburanti janë 8 shtëpi banimi dhe një banesë kolektive prej 5 etazheve në ndërtim e sipër.

-Një stacion ndër urban i autobusëve në largësi prej 20 metrave

-Hyrja në kazermën e FSK largësi 15 metra.

- nga 25 deri në 30 metra objekte afariste (depo)

Qarkullimi i shumtë i këmbësorëve në këtë hapësirë si dhe shfrytëzimi i kësaj hapësire dhe hapësirës pë~~r~~ rreth nga taksitë nga Kamenica, fshati Malishevë, Uglarë dhe Pogragjë është faktorë shtesë që ngritë rrezikshmërinë në këtë hapësirë

**Gjasat**




**Goditja**

| Banorë | Familje | Handikap | Femra | Meshkuj | Fëmije | Pleq | Të mirat materiale | Infrastrukt. Kritike | Objekte te rëndësisë së veçantë | Trashëgim. Kulturore | Dëmet Ekonomike (Kostoja) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 70 | 20 | | | | | | Objekte kolektive banimi | . | Kazerma e FSK | / | Vlerësimi në çmim |

-Fatalitete 3 deri 5; deri në 20 të lënduar seriozisht, mundësi evakuimi deri në 90 veta.

-Lokalizim i komplikuar i efektit

-Dëmet ekonomike mund të cilësohen mbi 100.000 €

-Zonë e incidentit ku komuniteti funksionon shumë pak,

| | |
|---|---|
| **Pasojat** | - Numër i konsideruar i qytetarëve me fatalitet dhe numër i lartë i personave të lënduar<br>- dëme të mëdha ekonomike në biznese dhe ~~dhe~~ ndërtesa kolektive dhe individuale të~~n~~ banimit<br>- strehimi i një numri relativisht të banorëve nga shtëpitë e dëmtuara<br>- funks~~c~~ionet vitale të infrastrukturës urbane për një periudhë 5-6 ditore jashtë përdorimit<br>- rivitalizim i biznesit 1- 3 muaj |
| **Skenari** | Rreth orës 16:10, pj~~r~~esëtarët e policisë lajmërojnë për një incident të rëndë që ka ndodhur në zonën afër kazermës së FSK, ku si pasoj e shpërthimit të një mase eksplozive e vendosur ~~një~~ një makinë të parkuar në hapësirën e pikës së karburantit Kosova P~~p~~etrol, për rrjedhojë ka ardhur edhe deri te eksplodimi i njërit nga rezervarët e benzinës të kësaj pike të karburantit. Nga dy eksplodimet e njëpasnjëshme me fatalitet kanë pësuar tre persona që ndodheshin në hapësirën e pikës së karburantit, dy persona që udhëtonin me makinë në rrugën magjistrale Gjilan-Bujano~~v~~c, katër persona që prisnin autobusin në stacionin. Lëndime kanë pësuar rreth njëzet persona bartja e të cilëve për në spitalin regjional ka filluar menjëherë me makinat e rastit. Dëmtime të rënda nga vala goditëse e eksplodimit ka pësuar edhe infrastruktura përreth ku më së shumti janë dëmtuar fasada dhe dritaret e shtëpive në rrugën “Halim Aga”, objekteve afariste në rrugën “Avdullah Tahiri” dhe tri makina që ishin në lëvizje në momentin e eksplodimit. Si pasojë e flakëve të mëdha të përhapura kanë filluar të ndizen pesë makina taksi të cilat kanë qenë të parkuara në afërsi të pikës së karburantit, një kioskë në afërsi të hyrjes në kazermës së FSK.<br>Të parët në vendin e incidentit kanë dal pjesëtaret e FSK të cilët kanë filluar evakuimin e të lënduarve nga hapësira e rrezikshme, kanë bllokuar trafikun dhe kanë filluar aksionin e kërkim-shpëtimit në hapësirën pë~~r-~~rreth vendit të incidentit dhe në objekte.<br>Pos FSK e cila ishte në vendngjarje që nga fillimi i incidentit, në interval kohorë prej pesë minuta ishin edhe ekipet e ndihmës së parë, zjarrfikësit, ekipet e KEK-ut dhe zyrtarët e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim.<br>Për shkak numrit të madh dhe viktimave dhe numrit të lënduarave, drejtori i Drejtorisë Për M~~m~~brojtje dhe Shpëtim, ka apeluar për angazhim të shtuar në Qendrën Spitalore Njësitet e Shërbimit të Zjarrfikjës dhe Shpëtimit e kanë futur zjarrin nën kontroll. Për shkak të dyshimit për akt terrorist policia po mundohet të bëj izolimin e zonës në mënyrë që të ruaj provat materiale për ekzaminim gjatë hetimit të këtij rasti. Mediat pandërprerë janë duke u bërë apel qytetarëve për ndihmë në dhurimin e gjakut.<br><br>Vërejtje: është punuar një skenar i vetëm pasi që gjasa dhe efekti i incidentit në lokacion nuk ndryshon. |

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

Formatted: Albanian

| Kategoria e rrezikut | Tekniko-teknologjike |
|---|---|
| Lloji | Objekt ekonomik |
| Rreziku | Eksplodim-zjarr |
| Modeli | Jo sezonal |
| Lokacioni: | Agmia petrol |

**Historiku**

Kjo pikë karburanti është ngritur në kompleksin tregtarë "Agmiacentar". Kapaciteti i rezervarëve është 2 X 30.000, litra dhe i rezervarit propan-butan 10 m³.
Rrezikshmëria në këtë zonë është permanente për shumë faktorë
-afërsia në distancë 30 m. e dy banesave kolektive njëra prej 8 etazheve dhe tjetra prej 6;
-fluksi i madh i qytetarëve deri në 2500, brenda një ore;
-parkingu me kapacitet prej 200 copë makinave;
-zyre të agjencive dhe banka në afërsi prej 10 m.;
-objekti i Ministrisë së Punëve të Brendshme, qendra e dokumenteve personale dhe e regjistrimit të automjeteve në afërsi 15 m.

**Gjasat**




**Goditja**

| Banorë | Familje | Hendikap | Femra | Meshkuj | Fëmije | Pleq | Të mirat materiale | Infrastrukturë kritike | Objekte te rëndësisë së veçantë | Trashëgim. Kulturore | Dëmet Ekonomike (Kostoja) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 200 | | | | | | | Objekte biznesi. Banesa kolektive | Objekti i Ministrisë se Punëve të Brendshme | | / | Vlerësimi në çmim |

-Fatalitete 5 deri 10; deri në 20 të lënduar seriozisht, mundësi evakuimi deri në 150 veta.
-Lokalizim i komplikuar i efektit
-Dëmet ekonomike mund të cilësohen mbi 100.000 €

**Pasojat**

- Numër i konsideruar i qytetarëve me fatalitet dhe numër i lartë i personave të lënduar
- dëme të mëdha ekonomike në biznese dhe ndërtesa kolektive banimi
- strehimi i një numri relativisht të banorëve nga banesat e dëmtuara
- funkseionet vitale të infrastrukturës urbane për një periudhë 5-6 ditore jashtë përdorimit
- rikuperimi i biznesit 1- 3 muaj

**Formatted:** Albanian

**Skenari**

Si pasoj e një pakujdesie të rastit me rastin e mbushjes së një automjeti me gazë vjen deri tek një aksident i rëndë me përmasa tragjike për jetën e personave, pronën dhe të mirat materiale. Me këtë rast nga eksplodimi i rezervarit të gazit marrin flakë 1 automjet dhe një kombibus me 12 udhëtarë në pritje për mbushje duke përfshirë edhe vetë objektin e pikës së karburantit. Nga djegia e objektit të pompës për shkak të temperaturës së madhe të krijuar merr flakë edhe rezervari nëntokësor i benzinës i cili gjithashtu arrin të eksplodoj. Me këtë rast vala goditëse e dy eksplodimeve të njëpasnjëshme arrin të godet dy filiale të bankave dhe tre të agjencive të sigurimit të veturave, zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nëntë makina të parkuara në parkingun e qendrës tregtare "Agmia" si dhe një motoçikletë në lëvizje në rrugën magjistrale Gjilan-Bujanovc. Nga eksplodimi i shkaktuar në vendngjarje humbin jetën tre persona, mbushësi dhe pronari automjeti si dhe ngasësi i motoçikletës. Plagë të rënda nga djegiet marrin edhe pesë persona që ndodheshin në minibus nga ana që i ekspozohej rezervarit të gazit, dhe katër persona tjerë të cilët ishin në afërsi të filialit të bankës dhe tre persona që ishin duke hyrë në qendrën e regjistrimit të automjeteve. Njëri nga këta të lënduar merr goditje direkt me djegie të shkallës së lartë dhe vdes në qendrën spitalore.

Nën ndikimin e eksplodimit, flaka arrin deri në ballkonet e objektit kolektiv të banimit ku me këtë rast në njërin nga ata fillojnë të digjen rrobat dhe gjësendet që gjendeshin aty. Si shkak i eksplodimit të fuqishëm, copa metali nga rezervari dhe makina që mbushej kanë arrit të godasin pikën vrojtuese në kazermën e FSK dhe pjesën ballore të qendrës tregtare "Agmia centar".

Ekipet e zjarrfikësve arrijnë me një vonesë të konsiderueshme për shkak të komunikacionit të dendur në qytet. Subjekti i parë reagues në këtë situatë ishte një patrullë policie e cila duke parë situatën alarmante kërkon përforcime në sigurimin e perimetrit të zonës së incidentit dhe duke ndërmarrë veprime urgjente të kërkim-shpëtim dhe duke organizuar edhe punën e banorëve vullnetarëve dhe kalimtarëve të rastit. Pas policisë arrijnë ekipet e urgjencës së Spitalit dhe QMF me gjithsejtë 3 automjete duke bërë fillimisht bartjen e të lënduarve dhe trupave pa jetë drejtë qendrës spitalore të qytetit.

Me arritjen e zjarrfikësve në vendin e incidentit dukshëm rriten kapacitetet reaguese në lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit. Përmes 112 kërkohet nga media që të sensibilizojnë tek qytetarët dhënien vullnetare të gjakut ku bartës i këtij veprimi do të jetë enti për transfuzionin e gjakut i ndihmuar edhe nga Kryqi i Kuq dhe organizata tjera humanitare. Komiteti komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim merr masa urgjente në mobilizimin e kompanive publike dhe private për eliminimin e gërmadhave të shkaktuara në infrastrukturë dhe objekte ekonomike dhe në banesa, ndërsa për 9 banorët e dy banesave të dala jashtë funksionit sigurohet strehimi deri në funksionalizimin e tyre, kurse për riparimin e pjesshëm të dy të tjerave merren masa të subvencionohen nga fondi komunal për fatkeqësi elementare dhe fatkeqësi tjera.

Pronari i pikës së shitjes së karburanteve dhe gazit, nën përcjelljen e pjrestarëve të policisë, shoqërohet në stacionin policor për hetimet e shkaqeve te incidentit.

| Kategoria e rrezikut | Tekniko-teknologjike |
|---|---|
| Lloji | Objekt ekonomik |
| Rreziku | Eksplodim-akt terrorist |
| Modeli | Jo sezonal |
| Lokacioni: | Penda e liqenit të Përlepnicës |

**Historiku**

Penda në Pëerlepnicëe është ndërtuar në rrjedhën e lumit Pëerlepnica nmëe vitin 1982. Penda është ndërtuar nga materiali rrethanor i marruar në afërsi të akumulacionit, bërthamë nga argjila ndërsa dy shtresa të tjera me gurët rrethanore.

- Penda e këtij liqeni ndodhët në kuotën 599 metra lartësi mbi detare, ndërkohë që vendbanimet nën trupin e saj kanë diferencë të theksuar të lartësisë mbidetare Perlepnice kuota 582,80, Kmetoci kuota 579.00, dhe Dobërqani kuota 574,40 lmd si dhe distancë të shkurtër nga trupi i pendës: Pëerlepnica ndodhet në mes gjatësive 0.9 km - 2.2 km; Kmetoci ndodhet në mes gjatësive 3.8 km, dhe Dobëerqani ndodhet në mes gjatësive 7.8 km- 8.2 km. Këta faktorë si dhe konfiguracioni i ngushtë i trenit në të cilin shtrihen këto vendbanime, krijojnë rrezikshmëri në rast të shpërthimit të trupit të pendës dhe atë për shkak se ngushtica gjeografike në të cilën ndodhën këto vendbanime nuk mundëson shpërndarje në gjerësi të kapacitetit të ujit prej 3.6 milion $m^3$, sa ka liqeni në kushte normale.

**Gjasat**




**Goditja**

| Banorë | Familje | Hendikap | Femra | Meshkuj | Fëmije | Pleq | Të mirat materiale | Infrastrukturë kritike | Objekte te rëndësisë së veçantë | Trashëgimi Kulturore | Dëmet Ekonomike (Kostoja) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | Objekte biznesi. sShtëpi banimi, ferma, kultura bujqësore | Shkolla, rrugë magjistrale dhe të rendit të dytë, rrjeti elektrik dhe i telefonisë | | Objekte të kultit | Vlerësimi në çmim |

-Një numër i madh njerëzish i goditur, me numër të konsiderueshëm fataliteti(>60), mMbi një qind të lënduar, më shumë se 230 të evakuuar
- Pasoja dhe dëme serioze në infrastrukturë
Shkatërrime të konsiderueshme, humbje për një kohë të gjatë e shërbimeve kyçe. Komuniteti e ka vështirë të funksionojë pa një mbështetje të fortë nga niveli Qendror dhe Ndërkombëtarë, mbi 20 milion Euro

| | |
|---|---|
| Pasojat | - Më shumë së 50 % të banorëve të goditur<br>- Shkatërrimi total i objektit të stacionit të filtrave<br>- Shkatërrimi i mbi 50 % të objekteve banimi, shkollave, QMF, zyrave të gjendjes civile,objekteve të kultit.<br>- Dëmtimi total i infrastrukturës kritike: rrjeti elektrik, ujësjellësit dhe infrastruktura tjetër<br>- Dëmtimi i mbi 50% të infrastrukturës rrugore,urave përgjatë lumit Përlepnica. |
| Skenari | Rreziqet e kategorizuara në shkallën katastrofë janë në kompetencë të drejtpërdrejtë të nivelit Qendror e cila është e obliguar që të hartoi edhe skenarët e mundshëm për këtë lloj rreziku. |

### 10.3 Vlerësimi i rrezikshmërisë për transportin rrugorë

Aksidentet e mëdha te trafikut të përmasave të mëdha vejnë në rrezik jetën e një numri më të madh i personave. Edhe pse komuna e Gjilanit është nyje komunikimi, konfiguracioni i terrenit bën që mos të ketë aksidente të përmasave të mëdha në të cilat rrezikohet jeta dhe prona e shumë personave.
Bazuar në përvojat e deritanishme dhe të dhënave zyrtare të shërbimeve përkatëse komunale dhe Policisë së Kosovës, në kontekst të pikave kritike në komunikacion, nuk është identifikuar ndonjë lokacion i cili do konsiderohej si pikë kritike në këtë drejtim, e që nënkupton se ato më tepër janë të natyrës individuale dhe në segmente rrugore të papërcaktuara.

## 10.4 Vlerësimi i rrezikshmërisë për epidemi

| | |
|---|---|
| **Kategoria e Rrezikut** | **Medikale** |
| **Lloji** | **Fatkeqësi natyrore** |
| **Rreziku** | **Pickimi i rriqrave Ethet hemorragjike Krime-kongo** |
| **Lokacioni:** | **Vendet ku qytetarët e Gjilanit kalojnë vikendet në piknik:**<br>**- Gryka e Stanishorit,**<br>**- Liqeni e Përlepnicës,**<br>**- Penda e Livoqit**<br>**- Kalaja e Pogragjës (gryka e Llapushës)**<br>**- Gryka e Karadakut (Zhegër-Shurdhan-Stanqiq)** |




**Identifikimi i rrezikut**

**Historiku**

**Ethet hemorragjike Krime-Kongo**
Për herë të parë në vitin 1956 është izoluar në gjak virusi si shkaktarë i etheve hemorragjike në Kongo të Belgjikës (tani Republika Demokratike e Kongos). Gjithashtu këtë lloj të sëmundjes e kanë përshkruar viteve 1940 në Krime (Ukrainë) me gjasë edhe në zonat e Azisë qendrore.

**Lajmërimi**
Lajmërohen në Evropën jug-lindore, Azi, në lindjen e mesme dhe forma të lehta edhe në Afrikë.
Rriqrat janë ektoparazite merimangore të rendit Ixodida nënklasa Acarina. Rriqërat ndahen në ato:
**Të forta (familja Nuttalliellidae dhe Ixodidae) dhe Të buta (familja Argasidae)**

**Rriqrat si shkaktar të sëmundjeve:**
Me pickim rriqra tek njeriu transmeton disa sëmundje. Për fat të mirë nuk janë të gjitha rriqrat e infektuara me mikroorganizma të cilat tek njeriu mund të jenë shkaktarë të sëmundjeve, të tilla janë një numër i vogël i tyre e po ashtu edhe shtrirja e tyre është e kufizuar në territore të caktuara. Territori jonë nuk posedon rriqra infektuese.
Rriqrat mundë të jenë bartëse të spirohetave të shumta, më së shpeshti të borelies (bakterja Borrelia burgdorferi) e cila shkakton sëmundjen e LLajmit e cila shërohet mirë nëse zbulohet herët. Në stadet e vonshme të kësaj sëmundje zhvillohen komplikimet si: artritisi, të ënjturit kronik të nyejve si dhe dëmtimet e sistemit nervor periferik.
Pickimi i rriqrave është i pa dhimbshëm kështu që pas çdo qëndrimi në natyrë duhet kontrolluar lëkurën e tërë trupit. Vëmendje të posaçme duhet përkushtuar kontrollit të pjesëve të trupit me lëkurë të ndjeshme (të butë), kurse te fëmijët duhet kontrolluar i tërë trupi. Nëse nuk largohet rriqra qëndron për një kohë të gjatë në trupin e "nikoqirit".
Për më tepër në: "Vlerësimin i rrezikshmërisë së pickimit nga rriqrat" Plani i veprimit kundër rriqrave" janar, 2009

| Vlerësimi i rrezikshmërisë | |
| --- | --- |
| Gjasa | Bazuar në situatën epidemiologjike të rasteve të pickimit nga rriqrat (56 raste për vitin 2009, deri me 15 korrik) dhe rezultimit negativ të ekzaminimeve klinik-laboratorik, llojet e rriqrave të regjionit të komunës së Gjilanit nuk janë bartëse të sëmundjeve infektive karakteristike për rriqrat .<br>Shkalla e rrezikshmërisë vlerësohet si **e ULËT**.<br> |

<table>
<tr><td>Kategoria e Rrezikut</td><td>Epidemiologjike</td><td rowspan="4">
</td></tr>
<tr><td>Lloji</td><td>Fatkeqësi natyrore</td></tr>
<tr><td>Rreziku</td><td>“Gripi i derrave- AH1N1 “</td></tr>
<tr><td>Lokacioni:</td><td>I tërë territori i Komunës</td></tr>
<tr><td colspan="3">Identifikimi i rrezikut</td></tr>
</table>

**Historiku**

Që nga fundi i muajit Prill 2009 e tërë bBota është njoftuar për fillimin e një kërcënimi të ri për shëndetin e tyre e cila prapë i përket një lloji të gripit por tani sipas shumë shkencëtarëve i kombinuar nga tri llojet e njohura atë njerëzor, gripit të shpezëve dhe atij të derrit. Rastet e para sivjet të këtij gripi të shënuar si gripi i derrave A (H1N1) e kanë prejardhjen nga Meksikaо prandaj edhe nga shumë qarqe shkencore fillon të quhet edhe si gripi Meksikan. Tani më shumë shtete në të gjitha kontinentet gati konfirmojnë prezencën e rasteve të prekura me këtë infeksion. Po ashtu, janë regjistruar edhe raste me vdekje të pacientëve të prekur nga kjo sëmundje. Por ja disa informata lidhur me këtë sëmundje që qytetarëve mund t’i ndihmojnë ta ruajnë dhe përparojnë shëndetin e vetë dhe të tjerëve.

**Ç’çështë gripi i derrave?**

Është sëmundje e organeve të frymëmarrjes të derrave e shkaktuar nga virusi i tipit A. Aktualisht tek njerëzit është raportuar infeksioni me virusin e gripit të derrave tipi H1N1.

**A sëmuren njerëzit nga gripi i derrave?**

Normalisht, njerëzit nuk sëmuren nga gripi i derrave, por infeksioni ndër njerëz mund të ndodh. Është raportuar se virusi i gripit të derrave përhapet nga njeriu në njeri, por nuk dihet saktësisht sa lehtë ndodh përhapja e virusit.

**Cilat janë shenjat e sëmundjes së gripit të derrave ndër njerëz?**

Shenjat janë të njëjta me ato të gripit të zakonshëm:

-temperaturë, kollë, dhembje fyti,
-dhembje koke,
-dhembje trupi,
-plogështi,
-vjellja dhe barkqitja në disa raste,
-komplikim më i shpeshtë i sëmundjes është ndezja e mushkërive,
-kuadri klinik i të sëmurëve kryesisht është i lehte deri te mesatarisht i rëndë,
-letalitet i ulët 1,9% të sëmurëve të konfirmuar flet për virusin me patogjenitet të dobët ose të rëndomtë, të lidhur me sezonin e zakontë të influencës,
-përfshirja e grup-moshave të reja shpjegohet me mungesë te imunitetit ndaj këtij virusi.

Për më tepër në: “Vlerësimin i rrezikshmërisë” nga “Plani i veprimit kundër gripit të derrave AH1N1” qershor/ 2009

| Vlerësimi i rrezikshmërisë | |
|---|---|
| **Gjasa** | Bazuar në situatën epidemiologjike të shteteve të rajonit si dhe kthimit për pushime të punëtorëve tanë që punojnë në shtetet tjera ,vlerësojmë se ne si komunë gjendemi në shkallën e lartë të rrezikut (Ngjyrë Portokalli)<br><br> |
| **Goditja** | - Një numër i madh i familjeve të goditur nga gripi me fatalitet dhe kërkesa e madhe për hospitalizim dhe trajtim medicinal,<br>- Paralizimi i jetës normale të familjeve me kohëzgjatje /organizimi i karantinës familjare,<br>- Mbështetje me personel e mjaftueshme nga niveli lokal,<br>- Mbyllja e institucioneve shkollore prej 7 deri në 10 ditë,<br>- Funksionimi JO normal i komunitetit (lëvizjet e kufizuara të komunitetit). |
| **Pasojat** | - Çrregullimi normal i zhvillimit të mësimit,<br>- Dëmtim të konsiderueshme në ekonomitë shoqërore dhe ato private (shkaku u lëvizjes së reduktuar). |

**Skenarët e mundshëm**

**Skenari- I**

Me rastin e kërkimit të ndihmës mjekësore nga ana e pacientit NN në PMF në fshatin Kishnapole dhe kontrollit të tij një javë më herët, nga ana e mjekut ka lindur dyshimi se i njëjti mund të jetë i prekur nga virusi i "gripit të derrave". Me këtë rast janë marrë masa në tri drejtime, në diagnostifikim, në dezinfektim dhe masa parandaluese, që virusi të mos përhapet nëse eventualisht do të konfirmohej si pozitiv, të njëjtit i është rekomanduar që t'i kufizoj lëvizjet e tij dhe kontaktet me persona tjerë bile edhe me familjar dhe pas një jave të paraqitet në kontroll.

Pas paraqitjes së tij në kontroll dhe pas përpunimit të rastit ka rezultuar si pozitivë. Dihet se pacienti NN jeton në bashkësi familjare pre 6 anëtarëve në fshatin Sllakoc i P~~p~~oshtëm i cili ka rreth 180 banorë. Fëmijët e këtij fshati mësimin e vijojnë në shkollën e fshatit Kishnapole e cila shkollë numëron afro 200 nxënës.

Fshati Sllakoc i P~~p~~oshtëm me qytetin e Gjilanit komunikon përmes rrugës lokale: Sllakoc i P~~p~~oshtëm, Kishnapole, Gadish, Ponesh, Gjilan, mirëpo i njëjti kufizohet edhe me komunën e Ferizaj~~i~~t me ç'rast e shfrytëzojnë rrugën lokale: Sllakoc i P~~p~~oshtëm, Ramjan, Ferizaj.

**Skenari -II**

Në fshatin Pasjan në QMF është paraqitur një rast i dyshimt se një pacient mundë të jetë prekur nga virusi i "gripit të derrave". Pacienti ka familje katër anëtarësh. Pas përpunimit të rastit ka rezultuar si pozitiv, sikurse edhe anëtarët e familjes kanë rezultuar si pozitivë dhe se ka pasur shenja të gripit në familje.

Fshati Pasjan ka afro 2000 banorë, në këtë fshat ekziston shkolla fillore e cila numëron afro 350 nxënës dhe shkolla e mesme me rreth 200 nxënës. Ky fshat me komunën e Gjilanit lidhet përmes rrugës magjistrale Gjilan-Preshevë.

**Skenari -III**

Pas trajtimit të pacientit MM në QKMF, banor i lagjes së "Gjinollëve" dhe përcjelljes së të njëjtit në QRSGj ku është hospitalizuar ka lindur dyshimi se ai vuan nga i ashtuquajturi "grip i derrave".

Pacienti kishte ardhur në Kosovë një javë më parë nga Zvicra.

Instituti i Shëndetit Publik ka njoftuar se nga dy llojet e analizave të kryera nga ta, kanë rezultuar të jenë pozitivë. Mirëpo, analizat janë kryer edhe nga laboratorët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, nga ku rasti rezulton pozitivë. Pacienti MM ka familje prej 3 anëtarëve, mirëpo jeton në bashkësi familjare me dy prindërit dhe me vëllai~~u~~n i cili ka një familje prej katër anëtarëve.

Dihet se qyteti i Gjilanit ka mbi 70.000 banorë, spitali, Institucionet e Arsimit (çerdhet, shkollat dhe fakultetet), Institucionet shoqërore dhe ato private, ndërmarrje të ndryshme prodhuese etj

# 11.0. Masat parandaluese për rrezikun nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera

## 11.1. Masat parandaluese për zjarret malore-fushore

Preventiva në zjarret malore dhe fushore
-Edukimi qytetar
-Lëvrimi i sipërfaqeve tokësore pas korrje-shirjeve
-Ndarja e sipërfaqeve me kultura gjatë fushatës së korrje shirjeve

Në pyje:
- Edukimi qytetar
- Tampon zona
- Ndalimi i ndezjeve të zjarreve pa leje paraprake si dhe sanksionimi i këtyre veprimeve
- Hapja e rrugëve malore për intervenim.

## 11.2. Masat parandaluese për vërshimet

**Reduktimi i përmbytjeve në zonat e ndikuara nga përmbytjet duke ndërmarrë masa teknike**

Historikisht, sikur edhe në vendet tjera në rajon, zvogëlimi i dëmeve si pasojë e përmbytjeve ka qenë i fokusuar më shumë në teknikat e mëparshme, që kishin të bënin me shmangien e përmbytjeve duke ndërtuar struktura për kontrollimin e tyre siç janë ndërtimi i digave kontrolluese, brigjeve dhe modifikimi i kanaleve. Megjithatë masat e tilla të kontrollit nëpërmjet strukturave, kanë rezultuar si jo të suksesshme gjatë kohës.

Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet në prona mund të menaxhohen me anë të kufizimit dhe kontrollit të zhvillimit në zonat e prira për përmbytje.

Meqë përmbytjet hyjnë në grupin e fatkeqësive të cilat mund të paralajmërohen, sikurse me anë të parashikimit të motit, kështu si rrjedhojë edhe zvogëlimi i dëmeve materiale të shkaktuara nga përmbytjet mund të bëhet duke marrë masat adekuate, siç janë: vendosja e thasëve me rërë përgjatë brigjeve të lumit, zhvendosjes infrastrukturës teknike shtëpiake nga niveli i cili mund të përmbytet etj.

**Veprimet parandaluese**

**-** Pastrimi, përmirësimi i shtratit të lumenjve dhe planifikimi i argjinaturave (brigjeve të ngritura artificialisht) do të minimizonte përmbytjet.

**-** Rregullimi i sistemit të drenazhimit për zonat të ndryshme duke mundësuar kullimin e këtyre zonave nga uji i grumbulluar nga reshjet atmosferike.

**-** Rregullimi i shtratit të lumenjve.

Të~~e~~ gjitha aktivitetet të lidhura me zvogëlimin dhe parandalimin e përmbytjeve duhet të behën duke e trajtuar në veçanti vlerat ambientale që ofrojnë lumenjtë dhe sipërfaqet ujore.
Gjithashtu zhvillimi i zonave të pritura për përmbytje duhet t'i paraprijnë masat adekuate për zhvillim. Gjatë hartimit të planeve rregulluese, bazuar në studimet për zonat e përmbytura, duhet kufizuar ndërtimin objekteve (në distancë të konsideruar) nga aksi i lumenjve. Objektet ekzistuese brenda kësaj zone nuk mund të zgjerohen dhe mbi ndërtohen.
Objektiva e masave parandaluese në zonat e zhvilluara përgjatë shtretërve të lumenjve është të kontrollojë ndërtimet ekzistuese në zonat e identifikuara dhe në veçanti të kufizojë zhvillimet e reja me që~~e~~llim të zvogëlimit të dëmeve dhe mbrojtjen e shtratit të lumit si vlerë natyrore.
Të gjitha aktivitetet që lidhen më reduktimin dhe parandalimin e përmbytjeve duhet të ndërmerren me kujdes duke trajtuar dhe ruajtur vlerat mjedisore që ofrojnë lumenjtë dhe përrenjtë

**Veprimet projektet për zbatim në zonën urbane**
**-** Ndarja e buxhetit vjetor për mirëmbajtjen e lumenjve
**-** Në rastin e ndërtimit të objektit në zonat afër lumenjve (jashtë zonës së mbrojtur), duhet të prezantohet projekti detal i drenazhimit të objektit dhe hapësirës ku ndërtohet objekti.
**-** Kufizimi i zhvillimeve në zonat të cilat historikisht janë të prira për përmbytje.
**-** Përmirësimin e këtyre zonave dhe dedikimi i tyre për sipërfaqe të gjelbra.

## 11.3. Masat parandaluese për shtrëngata dhe breshër

Zhvillimet tekniko teknologjike kanë bërë të mundur që shtrëngatat dhe breshëri si dukuri atmosferike të kenë mundësin e paralajmërimit dhe parandalimit. Ndër masat që duhet të merren për zvogëlimin e dëmeve nga këto dukuri janë:
- n~~N~~dërtimet e objekteve të banimit dhe ekonomike në përputhje me rregullat e ndërtimit;
- i~~I~~nspektimi dhe mbikëqyrja e gjendjes së objekteve nga inspektorati i ndërtimit;
- ndërtimi i një stacioni lokal meteorologjik;
- aktivizimin e sistemit të raketave që bëjnë shpërndarjen e reve me breshër.

## 11.4. Masat parandaluese për tërmetet

1: Aplikimi i kodit të ndërtimin-t dhe respektimi i rregullave bazë për rezistencë ndaj ndikimeve sizmike
I tërëe territori i komunës së Gjilanit është i rrezikuar nga ndikimi i tërmeteve me intensitet të ndryshëm. Hartat sizmike, të cilat janë pjesë e këtij dokumenti përcaktojnë nivelin e intensitetit të tërmetit për një periudhë të caktuar të kthimit. Për objektet banuese përdoren hartat me periudhë të kthimit 475 vite. Ndërsa, te objektet me rëndësi më të madhe siç janë pendat, përdoren hartat më periudhë të kthimit 100 vite.
Shfrytëzimi i këtyre hartave gjatë fazës së projektimit dhe zgjidhjes së lokacionit, përdorimi i koeficienteve adekuat gjatë llogarisë së objektit dhe respektimi i rregullave bazë për objektet me rezistencë ndaj tërmeteve do të kishte kontribut të jashtëzakonshëm në zbutjen e ndikimit të tërmeteve në objektet kritike dhe objektet tjera.
Qëllimi kryesor i përfilljes së rregullave për ndërtim të qëndrueshëm ndaj tërmeteve është që në rast të ndonjë tërmeti në të ardhmen të mos ketë humbje në njerëz dhe në dëme materiale sa më të vogla dhe të riparueshme. Për t'u përmbushur kjo objektiv duhet ndërmarr këto veprime:
- Organizimi i fushatave periodike (punëtori, stimulime) për vetëdijesimin e popullatës për rreziqet nga tërmetet.
- Fuqizimi i kapaciteteve komunale për kontrollimin e zhvillimeve në aspekt të ndërtimit rezistues nga forcat sizmike. Koeficientet sizmike si edhe parametrat e tjerë do të përcaktohen me anë të studimeve të veçanta sizmike të ashtuquajtura " mikrozinim i hapësirave ndërtimore”. Kontrolli duhet të verifikojë nëse objekti i cili do të ndërtohet përfillë masat për rezistencë ndaj tërmeteve për zonën dhe pozitën e dhënë.

2: Analizat inxhinierie dhe hapësinore për ndërtesat kritike dhe shfrytëzimi i hapësirave të tyre në rast fatkeqësie
Bazuar në analizat inxhinierike dhe hapësinore të identifikohen dhe vlerësohen objektet e përshtatshme që mund të shfrytëzohen si hapësira për evakuim në zonat të caktuara. Objektet e tilla të përshtatshme në qytet janë, shkollat, palestra sportive, etj.
Nga përvojat e mësuara rekomandohet që ky vlerësim duhet të fillojë sa më parë që është e mundur. Pas nxjerrjes së përfundimeve inxhinierie, të bëhet përforcimi i objekteve, bazuar në kriteret e identifikuara (tipologjia e strukturës së objektit, periudha e ndërtimit, kualiteti i materialeve ndërtimore të përdorura, madhësia e objektit, arsyeshmëria ekonomike, numri i shfrytëzuesve etj.)
Gjithashtu, vlerësimi i strukturës duhet të bëhet edhe për objektet tjera me karakter publik të shfrytëzimit të koncentruar në zonën qendrore të qytetit.
Intervenimet në strukturën mbajtëse te objektet shumëkatëshe të banimit, me qëllim të adaptimit të njësive komerciale kryesisht në përdhese, rrisin cenueshmërinë ndaj ndikimeve sizmike. Andaj, çdo veprim i kësaj natyre kërkon aprovimin e organit relevant të Komunës në mënyrë që të mos cenohet

aftësia mbajtëse e objektit. Arritja e këtijsaj objektivie, kërkon që të veprohet në drejtim të:

- vVlerësimit të qëndrueshmërisë së infrastrukturës kritike (shkollat, spitalet, urat, mbikalimet, pendat, etj.) dhe objekteve tjera me rëndësi ndaj ndikimeve sizmike.
- hHartimin e projekteve specifike për përforcimin e strukturave ekzistuese aty ku justifikohet arsyeshmëria ekonomike dhe funksionale.
- pPërforcimin e objekteve të infrastrukturës kritike me qëllim shfrytëzimin e tyre si qendra për evakuim në raste të fatkeqësive.
- Rreptësishtë të ndalohet ndërtimi afër shkarjeve aktive të tokës, të cilat konsiderohen të jenë potencialisht burim aktiv i tërmeteve në të ardhmen. Shtrirja e shkarjeve të tilla në territorin e komunës së Gjilanit është specifikuar në hartat sizmike të cilat janë pjesë e këtij dokumenti.

| Ndërtesa numër | Rruga ose kompleksi banesor | Katësia | Numri i banesave |
|---|---|---|---|
| 01-06 | Rr: "Gjon Sereçqi" (ish -Kamniku) | P+5 | 258 |
| 09-016 | Rr: "Gjon Sereçqi" (ish -Kamniku) | P+5 | 255 |
| 017-032 | Rr: "Esat Berisha"<br>Rr: "Xhevat Ajvazi" | P+4 | 243 |
| 036 | Rr: „Bulevardi i Pavarësis" | P+13 | 55 |
| 056 | Rr: „Bulevardi i Pavarësis" | P+4 | 63 |
| 057 | Rr: „Bulevardi i Pavarësis" | P+4 | 24 |
| 045 | Rr: „Bulevardi i Pavarësis" | P+4 | 27 |
| 046 | Rr: „Isa Boletini" | P+4 | 22 |
| 043 | Rr: „Avdullah Tahiri" | P+5 | 103 |
| 038 | Rr: „Avdullah Tahiri" | P+4 | 34 |
| 062 | Rr: „Avdullah Tahiri" | P+4 | 64 |
| 063 | Rr: „Adem Jashari" | P+4 | 43 |
| 065 | Rr: „Medllin Ollbrajt" | P+4 | 18 |
| | | | |

**Ndërtesat shoqëroro-publike në Komunën e Gjilanit dhe banesat kolektive me rrezikshmëri në rast tërmeti:**

## 11.5. Masat parandaluese për erozionin

Edhe pse territori komunës së Gjilanit nuk karakterizohet si zonë me shkallë të lartë të erozionit, prapë se prapë është e nevojshme të ndërmarrë masat e nevojshme për parandalimin dhe uljen e shkallës së erozionit gjatë zhvillimeve të reja. Në zonat ku mundë të shfaqet kjo dukuri~~ është~~ duhet të pyllëzohen dhe të ndërtohen barrierat aty ku është e nevojshme. Për të arritur këtë ndikuar në këtë drejtim duhet vepruar në:

- n~~N~~gritja e vetëdijes së komunitetit
- r~~R~~ipyllëzimi i sipërfaqeve të shpyllëzuara
- k~~K~~ontrolli i zhvillimeve në zonat ku shkalla e erozionit është më e lartë
- n~~N~~dërmarrja e masave të nevojshme gjatë ndërtimit të rrugëve në zonat rurale

## 11.6. Masat parandaluese për depot e materialeve të rrezikshme

Grupet e materieve të rrezikshme

1. Materiet eksploduese;
2. Gazrat e kthyera në Lëngje;
3. Lëngjet ndezëse;
4. Materiet e ngurta ndezëse;
5. Materiet oksiduese;
6. Helmet;
7. Materiet radioaktive;
8. Materiet korrozive-brejtëse;
9. Materiet tjera të rrezikshme;

Masat preventive të materieve t~~ ë~~e lëngëta ndezëse dhe ato lehët ndezëse te depot

- Stafi i trajnuar për manipulim me materie të rrezikshme
- Të ketë njësi zjarrfikëse
- Të posedojnë sistemet automatike për fikjen e zjarrit, sistemi Drenqer dhe Spinkler.
- Pajisjet për fikjen e zjarrit të kontrolluara sipas ligjit
- Sistemime mbrojtjes nga zbrazjet atmosferike
- Sistemet automatike për lajmërimin e zjarrit
- Depoja duhet të dislokohet së paku 3 km. larg nga vendbanimet;
- Ruajtja e materieve eksplodues bëhet ndaras veç materj~~eri~~ja veç iniciuesit;
- Lagështia përbrenda objektit duhet të jetë minimale;
- Pajisjet për fikjen e zjarrit duhet të jenë të mjaftueshme;
- Rrjeti i hidrantëve nuk duhet të ketë gyp prurës më i vogël se 50 mm;
- Objekti duhet të jetë domosdo i rrethuar;
- Duhet të ketë vëzhgim të pa ndërprerë 24 orë, fizik apo përmes kamerave
- Objekti duhet të jete i shënuar qartë dhe dukshëm me mbishkrimi për materie të rrezikshme

- Preferohet të mos ketë instalime~~it~~ të rrymës elektrike në depot e materialeve të rrezikshme;
- Hyrjet dhe daljet duhet të evidentohen dhe të lejohen vetëm për subjektet dhe personat e autorizuar;
- Transporti i organizuar në përcjellje të~~e~~ policisë.

### 11.8. Masat parandaluese për zjarret industriale

Kjo masë parandaluese përfshinë, Industrinë e Tekstilit, Industrinë e Miellit, Industrinë e Duhanit~~,~~ dhe Industrinë e Drurit. Çdo subjekt ekonomik që merret me këto veprimtari industriale duhet t'i siguroi këto kushte për parandalim nga zjarri:

1. n~~N~~jësinë e zjarrfikësve industrial;
2. r~~R~~regulloren për mbrojtje nga zjarri;
3. p~~P~~ajisje të mjaftueshme (aparate dore) për fikjen e zjarrit;
4. h~~H~~idrantët të kompletuar;
5. s~~S~~isteme për mbrojtje nga zbrazjet atmosferike
6. l~~L~~ajmëruesit automatik të zjarrit;
7. a~~A~~testimi një herë në vit të këtyre sistemeve;
8. s~~S~~istemet pneumatike
9. g~~G~~yp përcjellësit sipas rregullave
10. t~~T~~ym përcjellësit
11. v~~V~~entilim
12. ~~P~~palosja në depo duhet bërë në ambalazhe dhe grumbull deri në 30 në një vend;
13. ~~L~~lartësia e grumbullit mos te tejkaloi 3 m;
14. k~~K~~rijimi i hapësirës së lirë për qarkullim;
15. k~~K~~rijimi i distancave të mallrave nga poçet elektrike.

### 11.9. Masat parandaluese për objekte të rëndësisë së veçantë

Një nga objektet e rëndësisë së veçantë i cili është jetik për funksionimin e jetës normale në komunën e Gjilanit, ku nga ndonjë avari në të rrezikohet jeta dhe siguria e qytetarëve në shkallë të gjerë, është penda e liqenit të Përlepnicës. Ky objekt në këtë nivel mundë të rrezikohet nga faktorët natyrorë (tërmeti) dhe nga faktori njeri (aktet terroriste)

Masat që duhet ndërmarr për të parandaluar kërcënimet dhe që~~e~~ndrueshmërinë e këtij objekti janë:

- s~~S~~ë~~e~~ paku një herë~~e~~ në vitë~~e~~ të bë~~e~~het matja gjeoteknike e stabilitetit të trupit të~~e~~ pendës dhe të konstatohet në mënyrë profesionale stabiliteti i saj.
- h~~H~~yrjet dhe daljet duhet të evidentohen dhe të lejohen vetëm për subjektet dhe personat e autorizuar;
- d~~D~~uhet të ketë vëzhgim ~~të~~ pa~~–~~ndërprerë 24 orë, fizik apo përmes kamerave

### 11.10. Masat parandaluese për rrezikun nga gripet dhe epidemitë

Situata emergjente në aspektin epidemiologjike paraqet gjendjen kur në një hapësirë të caktuar papritmas dhe për një kohë të shkurtër vjen deri te kërcënimi për shëndetin ose jetën e njerëzve të cilat pasoja nuk mund të zgjidhen në kohe të caktuar dhe me mjete të dëshirueshme të shërbimeve shëndetësore ekzistuese. Situata emergjente është një apo një seri ngjarjesh që janë një rrezik për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e bashkësisë apo banorë të një zone siç janë. Në aspektin epidemiologjik, përpos që epidemitë mund të godasin në kushte normale, vatrat permanente të shpërthimit të epidemive më të shpeshta mundë të ndodhin: gjatë luftërave dhe katastrofave natyrore që zakonisht shkaktojë krizat humanitare.

Karakteristikat themelore të gjendjeve të~~e~~ jashtëzakonshme të shkaktuara nga epidemitë janë:

-n~~N~~dikojnë në numër të madh të njerëzve,
- s~~S~~hkaktimi i dëmit serioz në shëndetin e popullatës dhe të aktiviteteve shoqërore,
- s~~S~~htohet nevoja për ndihëmë në një numër të madh banorësh.

Goditje më e theksuar e epidemive shkaktohet sidomos në fatkeqësi natyrore, pasi një ngjarje katastrofë nga një fatkeqësi natyrore shkaktohen të papritura, ndryshimet drastike~~ në~~ jetësore,të një numri të madhë njerëzish ku ndër më kryesoret janë:

-p~~P~~ërkeqësimi i kushteve të jetesës,
- f~~F~~urnizimi i ndërprerë ujit të pijshëm dhe rezervave ushqimore,
- p~~P~~ërkeqësimi i kushteve sanitare,
- l~~L~~odhja f~~F~~izike dhe mendore.

Në këto kushte, aktivitetet normale në monitorimin dhe luftën kundër sëmundjeve infektive janë shumë të vështirë~~o~~suara të cilat e komplikojnë situatën epidemiologjike. Kushtet e vështirësuara dhe të ndryshuara të jetës janë shumë të favorshme në paraqitjen dhe përhapjen e sëmundjeve infektive. Në situata të tilla është e rëndësishme të intensifikohet mbikëqyerja epidemiologjike dhe vrojtimi i terrenit që njëherit të bëhet studimi epidemiologjik i zonave të~~e~~ atakuara.

Mbrojtja e shëndetit në situata emergjente paraqet të gjitha format e mundshme të aplikueshme të mbrojtjes shëndetësore, epidemiologjike të cilat bëhen në kushte normale shëndetësore.

Menjëherë pas fatkeqësive duhet ndërmarrë~~e~~ të ashtuquajturat masat e urgjencës:

1. e~~E~~vakuimin dhe strehimin e popullsisë se atakuar,
2. s~~S~~igurimi i ujit të pijshëm dhe ushqimit
3. g~~G~~jetja dhe varrimi i të vdekurve,
4. l~~L~~ufta kundër çrregullimeve mendore,

5. i~~I~~nformimi me kohë dhe i saktë~~e~~ i popullatës.
Varësisht nga natyra e fatkeqësive në përbërjen e stafit, përveç profileve të tjera të eksperteve duhet të marre~~ë~~ pjesë~~e~~ gjithnjë edhe mjeku specialist i epidemiologjisë dhe higjienës.

## 12.0. Infrastruktura e alarmimit dhe lajmërimit në rast të Fatkeqësive Natyrore dhe Fatkeqësive tjera

Në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, organet komunale duhet që me kohë të alarmojnë për gjendjen e rrezikut dhe për të gjitha veprimet dhe udhëzimet për popullatën. Për këtë më të përshtatshmet janë mjetet e informimit masiv më të cilat është e mbuluar komuna

| TV-të dhe radiot | | Vërejtje |
|---|---|---|
| **Institucioni** | **Zona e mbulimit** | |
| RTK, TV-21 dhe KTV | K~~k~~omunën e Gjilanit dhe më gjerë | Kontakti gjithnjë përmes zyrtar~~t~~it për informim të KKMSh |
| TV-Vali | K~~k~~omunën e Gjilanit | |
| Radio-Viktoria | -II- | |
| Radio-Rinia | -II- | |
| Radio-Energy | -II- | |
| Radio-Megavox | -II- | |
| Radio-Gjilani | -II- | |

Një ndër format dhe mundësitë e alarmimit është edhe ajo përmes monumenteve fetare (përmes autoparlantëve të xhamive në lokacionet ku ndodhen ato.

## 13.0 Stërvitja fushore

**Ushtrimit p~~P~~ublik në Gjilan, me fillim në ora 12.00, në të cilin do të marrin pjesë të gjitha njësitë emergjente, Policia e Kosovës.**

Detyrat për Njësitë pjesëmarrëse janë:

1. s~~S~~igurimi i vendit të incidentit
2. d~~D~~hënia e ndihmës ë parë
3. s~~S~~huarja e zjarrit në një apartament;
4. e~~E~~vakuimi i banorëve nga katet e larta të ndërtesave;
5. n~~N~~xjerrja e të aksidentuarve nga makinat;
6. b~~B~~artja e të lënduarve në qendrën spitalore;

**Baza-lindja 1,** ngarkohet me kryerjen e detyrave me sa vion:
Prej orës 11;50–12;50, personi zyrtarë në 112 është pe~~ë~~rsoni që duhet të punojë në sistemin e radiolidhjeve~~,~~ dhe lidhjeve telefonike duke i evidentuar saktë të gjitha thirrjet telefonike, llojin e bisedës. Pas marrjes së lajmit prej orës 12;00–12;02 minuta do ta alarmojë për aksidentin e simoluar ku do të ketë edhe viktima Shërbimin e Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Policinë e Kosovës dhe ndihmën e parë.

### Komandant incidenti – lindja 10

Nga vendi i ngjarjes komunikon me lidhjen e cila ndodhet në postëkomandën e incidentit si dhe në vijën horizontale me lindjen 11-sulmi 1, me lindjen 12 sulmi 2. me lindjen 13 sulmi 3 dhe me lindjen 14 sulmi 4. (merr informata nga të lart-cekurit, iu jep urdhra për kryerjen e punëve dhe i bart informatat në vijën vertikale drejt postëkomandës)

**Lindja 11- sulmi 1**
Lokalizimi dhe shuarja e zjarrit fillestar me aparat dore, përgjegjës për këtë pikë~~e~~ të ushtrimit është:
Grupi i zjarrfikësve

1. përgjegjësi dhe dy ndihmës.

**Lindja 12-sulmi 2**
Shpëtimi dhe vet shpëtimi nga lartësia përmes litarëve, ekzekutues të kësaj pike janë:

SHZSH-ja të cilët do të bëjnë shpëtimin dhe vet shpëtimin sipas kësaj renditje:

1. i~~I~~ pari do të lëshohet nga lartësia pjesëtar i~~o~~ Policisë së Kosovës
2. i~~I~~ dyti oficer~~i~~ i SHZSH
3. i~~I~~ treti nga SHZSH
4. i~~I~~ katërti nga SHZSH
5. i~~I~~ pesti nga SHZSH
6. i~~I~~ gjashti nga SHZSH
7. i~~I~~ shtati nga SHZSH

Përgjegjës për këtë pikë është zëvendës komandanti i SHZSH.

**Lindja 13 – sulmi 3**

Është pika ku do të demonstrohet tërheqja e viktimave nga automjeti i aksidentuar, bëhet prerja e automjetit me vegla dhe mjete hidraulike nga gjashtë pj~~r~~esëtarë të SHZSH:

1. udhëheqës i aksionit.
2. makinist.
3. prerësi me gërshërë hidraulike.
4. zgjë~~e~~ruesi hidraulik.
5. ndihmës në incident
6. kujdesi ndaj viktimës.

Përgjegjës për këtë pikë ekzekutuese është zjarrfikësi nga SHZSH

**Lindja 14 – sulmi 4**

Me të arritur në vendin e ngjarjes, fillimisht të gjithë pj~~r~~esëtarët rreshtohen, pritet urdhri për verifikimin e gazrave toksike, kthehet nga objekti verifikuesi dhe konfirmon se nuk ka gazra toksike:

**Epet urdhri për veprim të~~i~~ ekipit veprues**

1. përgjegjës i u~~U~~shtrimit – **lindja 14 – sulmi 4**
2. makinist-kërkues në objekt.
3. makinist-kërkues në objekt.
4. makinist –kërkues në objekt.
5. zjarrfikës
6. zjarrfikës
7. zjarrfikës.
8. zjarrfikës
9. zjarrfikës
10. 4 oficer të PK-së
11. për përfundimin e ushtrimit do të bëjnë kryqëzimin e ujit në lartësi.